


PËRFAQËSON POPULLIN



ME DINJITET

E DREJTA E ARSIMIMIT NË DEMOKRACI

ALBULENA (12), FATJON (12), AGNESA (12), ALBION (13), ERZA (13), UTHMAN (12), FJOLLA (13)



Fuqinë që ne e kemi, ua japim deputetëve

Ne jetojmë në një epokë në të cilën e drejta arsimimi është shumë e rëndësishëm. Falë saj ne si qytetarë shkollohemi, mësojmë të shkruajmë, mësojmë të lexojmë, etj. Nëse ne nuk do të kishim këtë të drejtë, atëherë ne nuk do të dinim as të shkruajmë e as të lexojmë.

Pastaj, nuk do të arrinim asgjë në të ardhmen tonë. Madje, nuk do të mund ta ushtronim profesionin që na pëlqen. Ne nuk do të arrinim të krijojmë as shoqërinë të cilën e kemi me të tjerët. Kjo për shkak njohuritë tona do të ishin të kufizuara, dhe do e kishim të vështirë të bisedojmë për çështje të ndryshme. Prandaj ekziston e drejta e arsimit.

Në Kosovë, e kemi ligjin për arsim, i cili e obligon çdo fëmijë të shkollohet deri në klasën e IX-të. Ndërsa, më pas, nxënësit mund ta vazhdojnë shkollimin sipas dëshirës së tyre. Arsyeja se pse ekziston ky ligj është që të mos mbetemi të pa informuar për gjërat bazike të cilat mësohen në shkollë, e të cilat na ndihmojnë të përgatitemi për jetë. Kjo është njëra ndër të drejtat e shumta të cilat i kemi në Kosovë.

Kosova është shtet demokratik që nga data 17 shkurt, 2008. Që nga ajo ditë, ne i gëzojmë të drejtat tona ashtu siç e meriton çdo individ. Demokracia nënkupton kur populli e ka fuqinë në shtetin e vet. Pra, qytetarët e kanë pushtetin në dorë, dhe me ata vendosin për të ardhmen e tyre. Dy llojet më të përhapura të

demokracisë janë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe ajo përfaqësuese.

Demokracia e drejtpërdrejtë është kur i gjithë populli vendos për shtetin në mënyrë të drejtpërdrejtë. E kjo formë e demokracisë nuk zhvillohet në shtetin tonë, sepse ne kemi demokraci përfaqësuese. Ne votojmë për kandidatët të cilët ne mendojmë se ata mund ta udhëheqin shtetin tonë më së miri.

Ne zgjedhim deputetët dhe ata flasin në emrin tonë. E kjo formë e demokracisë quhet demokraci përfaqësuese me sistem parlamentar. Ne këtë artikull e shkruajmë për ju të dashur lexues, me qëllim që t'iu informojmë më shumë për rëndësinë e demokracisë dhe vlerat e mëdha që ka ajo.



E duam dhe e mbrojmë sistemin më të mirë të qeverisjes

„DEMOS-TI“ ISHTE ZGJEDHJA JONË

EMIR (12), DJELLZON (11), ANITA (12), AGON (12), AGNESA (13), VLERA (12), ERDONA (12)


Demokracia është sistem i gjithëpërfshirjes. Ajo nuk ka qytetarë të preferuar por çdo njërin e trajton në mënyrë të barabartë. E fillë është edhe demokracia e vendit tim

Shumë të dashur lexues, sot ne nxënësit e shkollës „Dëshmorët e Qëndresës“ ishim pjesë e Punëtorive të Demokracisë „Demos-ti“. Ardhja jonë në këtë vend kaq të dashur është meritë e kujdestarit tonë të klasës. Po ashtu, edhe meritë e jona si nxënës. Arsyeja pse themi kështu është se në fillim kujdestari na tregoi se nëse sillemi mirë dhe tregojmë rezultat të mirë në shkollë ai ka për të na mundësuar këtë vizitë. Pra, dëshira dhe vullneti ishte i dy anshëm, por kjo varej shumë edhe nga sjelljet tona. Ajo çka ne bëmë ishte një marrëveshje e klasës ku të gjithë premtuam që do të japim maksimumin në shkollë dhe do të sillemi mirë. Ne e bëmë zgjedhjen më të mirë, e cila na u shpërblye sot. Çdo punë e cila bëhet me dëshirë dhe qëllime të mira, padyshim që sjellë edhe rezultat të mirë. Prandaj edhe duhet të vendosim e të zgjedhim me kujdes. Kësh-

tu duhet të veprojmë edhe për zgjedhjet politike. Në vendin tonë zhvillohen dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet lokale dhe qendrore. Në zgjedhjet lokale, qytetarët votojnë për kandidatët për kryetarë të komunës dhe asamblistët. Kandidatët për zgjedhje lokale, duhet të jenë qytetarë të regjistruar në komunën përkatëse. Nuk mundet një qytetarë i cili është i regjistruar në Klinë të kandidoj për zgjedhje lokale në Gjakovë dhe anasjelltas. Ndërsa, në zgjedhjet qendrore, qytetarët votojnë për kandidatët për deputetët të cilët miratojnë ligje në mirën e qytetarëve të Kosovës. Si në zgjedhjet qendrore ashtu edhe ato në ato lokale, qytetarët që kanë drejtë vote janë ata mbi moshën 18 vjeçare. Sipas grupit tonë, qytetarët duhen të ndihen të lirë për të votuar atë që mendojnë se do të punojë në të mirën e tyre dhe të vendit. Vota është dhe duhet të jetë e lirë.



„Demos-ti“ zgjedhja më e mira që kemi bërë ndonjëherë



Disa qytetarë duke bashkëbiseduar për zgjedhjet



Këtu kemi paraqitur disa vizatime që tregojnë për zgjedhjet. Dëshirojmë të ndalemi pak tek vizatimi i fundit, zonja me të birin. Ajo është duke votuar por në të njëjtën kohë shikon të birin dhe mendon se unë sot po votoj, por vota ime do të sjellë ndryshime pozitive edhe për ty. Sot votoj unë, e në të ardhmen e afërt do të gëzosh edhe ti këtë të drejtë

INSTITUCION I BARAZISË DHE PAQES

BAJRAM (12), AIDA (12), ERZA (12), REJMONDA (12), LORESA (12), LABINOT (12), LUAN (12), ARJON (12)



Lexues të dashur, a e dini se kush është institucioni i barazisë dhe i paqes në Kosovë?

Ky institucion për të cilin po flasim është Kuvendi. Kuvendi siç edhe e keni parë nga titulli i gazetës, është institucion që e përfaqëson popullin me shumë dinjitet. I tërë ky përfaqësim rrjedh nga puna e palodhshme e deputetëve që punojnë aty. Detyra themelore e deputetëve është që të na përfaqësojnë ne qytetarët-



Kuvendi miraton ligje edhe për mua

duke sjellur ligje të reja dhe efektive. Këto ligje vihen në zbatim për të gjithë qytetarët, pa asnjë dallim. Kjo dëshmon faktin se nga puna e Kuvendit, të gjithë qytetarët kanë përfitim në mënyrë të barabartë. Një shembull për përfitimin e qytetarëve, janë edhe ligjet për arsimin të cilat kanë siguruar që ne të kemi të drejtën e shkollimit dhe të trajtohemi të barabartë në këtë aspekt. Një nga ligjet që ka miratuar Kuvendi për arsimin parauniversitar është që të gjithë nxënësit të jenë

të përjashtuar nga çdo lloj diskriminimi që mund të ndodh brenda institucioneve shkollore. Këtu përfshihet mospërdorimi i dhunës ndaj nxënësve, mospërdorimi i shprehjeve fyese, mosbërja e dallimeve të nxënësve, etj. E tërë kjo sigurohet vetëm që të arrihet mirëqenia dhe barazia mes nxënësve. Pra, siç po e shihni të dashur lexues, Kuvendi ka rol shumë të rëndësishëm në jetën tonë, sepse falë ligjeve të miratuar aty, ne fitojmë vlerë dhe respekt si qytetarë. Prandaj, është e rëndësishme që kur populli të del në votime për zgjedhje parlamentare, të bëjë zgjedhjen e duhur për të mirën e vendit. E tërë qeverisja varet nga duart e popullit. Prandaj, ndikimi i popullit në demokraci është i patjetërsueshëm. Punën e Kuvendit e lehtësojmë ne me zbatimin e ligjeve të marra aty. Pikërisht për këtë arsye, apelojmë tek të gjithë ju qytetarë që të jeni të përgjegjshëm për veprimet tuaja. Vetëm kështu ndërtohet shteti demokratik.



Edhe ne mund të jemi përfaqësues në të ardhmen

FUNKSIONET E KUVENDIT TË KOSOVËS

Kuvendi i Kosovës ka tri funksione kryesore: funksionin përfaqësues, funksionin legjislativ dhe funksionin kontrollues. Secili nga funksionet i ka detyrat e veta, të cilat i kryejnë deputetët. Se cilat janë këto detyra, lexojeni artikullin në vijim

Kuvendi zgjedhet nga populli, për këtë arsye ai luan rol përfaqësues. Kuvendi propozon dhe miraton ligjet, prandaj ai ka funksion legjislativ. Kuvendi ka rol kontrollues, sepse e kontrollon punën të cilën e bën Qeveria.

Ndër të tjerash, deputetët e zgjedhur nga populli, për detyrë kanë të zgjedhin Kryetarin e Kuvendit, Presidentin dhe Qeverinë. A po e vëreni pra të dashur lexues se çfarë roli ka Kuvendi në jetën tonë?

Falë demokracisë ne përfirojmë shumë. Andaj, jemi të lumtur për ekzistimin e këtij institucioni demokratik ligjvënës. Ky institucion përfshinë 120 deputetë, në mesin e të cilëve janë 20 nga komunitetët jo shumicë, sepse demokracia duhet të zbatohet në çdo hap dhe në çdo vend.



Shkruajmë dhe mësojmë për Kuvendin



Ligji kundër diskriminimit



Ligji për arsimin



Ligji për të drejtat e fëmijëve



Ligji për të drejtën e punës



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Dëshmorët e Qëndresës“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gllarevë, Klinë